

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë
Tel/Faks +355 4 234885
E-mail prokurimet@albaniandf.org
Ueb-faqe www.albaniandf.org

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

E-mail prokurimet@albaniandf.org.

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur mbi kufirin e larte monetar, Marreveshje Kuader.

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: Furnizim Mall

5. Numri i referencës së procedurës /Lotit: Loti 1: Ref- 74536-07-07-2023.

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Loti 1: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët-materiale ndertimi lëndë e parë Faza II.”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): -3161410-0, 44111000-1, 44111000-4, 4411300-5.

8. Fondi limit/marreveshjes kuader: 187,500,000 lekë pa TVSH.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

Neni 127 të LPP pika 1/c ku parashikohet; “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”.

Modifikimi është bere i nevojshem per rrethanat e meposhtme:

- Gjate procesit te perzgjedhjes se projekteve e ne vijim te thirrjeve te paraqitura nga bashkrite, eshte konstatuar se lista e objekteve prioritare te kerkuara nga bashkrite respektive ka kaluar parashikueshmerine e AK ne momentin e hapjes se procedures.
- Me zbatimin e Marreveshjes nepermjet minikontratave të lidhura aktualisht, eshte konstatuar nje numer shume i larte i kërkesave të bashkive për këtë tipologji materialesh, i cili dhe ka vijuar të rritet edhe pas perdorimit te pjesës më të madhe fondit të kësaj marrëveshje. Identifikimi i projekteve dhe thirrjeve nga bashkrite respektive ka qene shumë-fish me teper, duke e bere te pamundur akomodimin e te gjitha objekteve prioritare brenda kesaj marreveshje.
- Aktualisht FSHZH, ne Programin Operacional dhe detajimin buxhetor 3 vjeçar nuk ka te riplanifikuar furnizimin me materiale të kesaj natyre dhe tipologjie, pra eshte e pamundur qe ne kete moment te akomodohen dhe te permbushen nevoja te paparashikuara prioritare te paraqitura nga bashkrite, nepermjet nje procedure te re.
Kjo, pavaresisht edhe arsyetimit qe, edhe nese nje procedure e re do te ishte e planifikuar dhe buxhetuar, do te kerkonte kohen e vet, konsideruar ketu afatet e kerkuara ligjore të procedurave të prokurimit për marrëveshjen kuadër, por edhe të minikonkurseve (shpallje, vleresime, ankesa,etj), te cilat do te ndikonin në zgjatje të procedurave për finalizimin e një marrëveshje tjetër kuadër për realizimin e projekteve sipas kerkesave të bashkive, dhe per rrjedhoje mos permbushjen e nevojës se paraqitur si prioritare ne kete periudhe.
- Me shkresë nr. 23917/153 prot., datë 12.02.2024 të MF është miratuar detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale sipas programeve respektive, ku dhe eshte perfshire shtesa e buxhetit ne masen 20%. Ne keto kushte, duke konsideruar qe ne buxhetin maksimal te projektfishes qe mbulon kete objekt, eshte miratuar buxheti shtese i lejuar nga Ministria e Financave, gjykohet qe nevoja e objekteve te paparashikuara te mbulohet nepermjet modifikimit te vleres shtese te marreveshjes kuader aktualisht ne zbatim. Vlera shtese eshte perllogaritur ne baze te sasive dhe zerave te mallrave referuar listes se objekteve sipas kerkesave te bashkive
- Vlen të theksohet po ashtu se modifikimi i kesaj marreveshje, nuk e ndryshon ne thelb natyren e M.K, duke sqaruar se me zbatimin e nderhyrjeve prioritare shtese, kushtet jane te njëjta, nuk ndryshon në asnje moment objekti i kontrates, tipologjia e furnizimit eshte e njejte duke iu permbajtur keshtu zerave/mallrave te dakordesuar ne kete marreveshje. Modifikimi/shtesa e vleres se marreveshjes nenkupton shtesë në sasinë e furnizimit të materialeve dhe jo rritje te vleres per te njejtin mall/sasi.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Për shkak se:

- a. “Duke marrë në konsideratë kërkesat e bashkive nëpërmjet thirrjes së hapur nga FSHZH, nevoja për furnizimin me materiale ndërtimi për realizimin e investimeve infrastrukturore nga bashkitë

është rritur përtej fondit të marrëveshjes. Për të bërë të mundur furnizimin me materiale ndërtimi për realizimin e investimeve infrastrukturore nga bashkitë, vlera aktuale e MK nuk i mbulon punimet shtesë, kërkohet modifikimi i vlerës shtesë të marrëveshjes në shumën 37,500,000 lekë pa tvsh, vlerë kjo që nuk e tejkalon 20% e MK.”

b. Me shkresë nr. 59/1 Prot. date 22.01.2024 të FSHZH-së është kërkuar miratimi i detajimit të buxhetit sipas programeve.

c. Me shkresë nr. 23917/153 Prot., datë 12.02.2024 të Ministrisë së Financave është miratuar detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale sipas programeve.

Bazuar në:

a) Nenin 127 të LPP pika 1/c ku parashikohet; “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”.

b) Faktin që vlera monetare e modifikimit, nuk e tejkalon 20% të vlerës së marrëveshjes dhe nuk e ndryshon në thelb natyrën e saj.

c) Kërkesën dhe relacionin për amendim të Marrëveshjes Kuadër të miratuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Programeve, modifikohet vlera totale me vlerën shtesë 37,500,000 lekë pa TVSH.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 187,500,000 lekë, pa TVSH

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 225,000,000 lekë pa TVSH

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 24 muaj

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

OE “CURRI” sh.p.k NUIS J67902718S, me adresë: Njësia Administrative Nr. 10, Rruga “Kajo Karafili”, Nd.2, H.4, Ap. 3, 1001, Tiranë.

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 26.02.2024

16. Burimi i financimit: Buxheti Shtetit.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____